



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:280807

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855635

KF.nr.362/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit “N.T.P Arbëri” Sh.P.K., me seli më Glllogoc të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hasan Haxhaj, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti detyrime doganore shtesë, vlerë kontesti 11,199.67 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Hasan Haxhaj Avokat dhe të përfaqësueses të autorizuar të palës së paditur A.H.D., me datë 03.06.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit “N.T.P Arbëri” Sh.P.K., me seli në Glllogoc.
- II. ANULOHET PJESËRISHT aktvendimi me nr.01.3.22/11814 i datës 02.12.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën e vendimit ku është konfirmuar aktvendimi me nr.01.3.22/11814 i datës 30.10.2019 i Doganës së Kosovës, me të cilin vendim paditësi është ngarkuar me pagesën e taksës së akcizës në shumë prej 8,200.00€ dhe TVSH-së në shumë prej 1,576.49 €.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit SH.P.K. “N.T.P Arbëri” Sh.P.K., me seli më Glllogoc t’ia kthej pagesa e detyrimeve të paguara më tepër dhe atë në emër të taksës së akcizës shumë prej 8,200.00 €, TVSH-së shumë prej 1,576.49 €, e të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 9,776.49€ (nëntë/mijë/e/shtatëqind/e/shtatëdhjet/e/gjashtë/euro/e/dyzet/e/nëntë/cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga data 15.08.2019 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

- IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë që i referohet taksës doganore në shumë prej 511.30 € dhe në emër të TVSH-së në shumë prej 911.81 €.
- V. MBETET NË FUQI aktvendimi nr. 01.3.2.2/11814 i datës 02.12.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën ku është konfirmuar aktvendimi me nr.01.3.22/11814 i datës 30.10.2019, i Doganës së Kosovës në të cilin vendim paditësi është obliguar të paguaj taksën doganore në shumë prej 511.30 € dhe TVSH-në shumë prej 911.81 € apo gjithsej në shumë prej 1,423.11 €.
- VI. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 14.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, respektivisht kundër Aktvendimit 01.3.22/11814 i datës 02.12.2021, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale nga neni 16 pika 1.1 të LKA-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike (neni 16, pika 1.3 të LKA-së) dhe aplikimi të gabuar të së drejtë materiale, me propozim që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës 01.3.22/11814 datës 02.12.2021, të obligohet që paditësi t'ia kthej shumën e ekzekutuar prej 11,199.67 € në emër të gjobës administrative me kamatë vjetore nga data 15.08.2019 e deri në pagesën e tërësishme, po ashtu që obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, për taksë gjyqësore 150 + 105 =255.00 € dhe për padi shumën prej 208.00€ apo gjithsej shpenzime në shumë prej 263.00€. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: pas dëgjimit të ekspertes bëjë precizmin e kërkesëpadisë ashtu që riformulohet pika e 3 e kërkesëpadisë si në padi e cila tani do të jete: Obligohet DK-ja që paditësit të ia kthejë shumën e ekzekutuar prej 11.199.67 €, dhe atë në emër të taksës doganore shumën prej 511.30 €, në emër të akcizës shumën prej 8.200.00 €, në emër të TVSH –ës shumën prej 2.488.37 €, si dhe të detyrohet e paditura të kompensojë paditësit dëmin e shkaktuar me aktvendimi kontestues dhe atë shumën prej 800.78 €, në emër të kamate vonesës sipas urdhër pagesës 201014000000148 e datës 29.07.2020, si dhe të kompensojë edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të krijuara tek përmbaruesi Sefer Sh. Arifi sipas numrit të lëndës P.nr.12/20 në shumë prej 1,003.02 € e të gjitha me kamate ligjore prej 8 % nga data 15.08.2019 e deri në realizimin e plotë. Aktvendimi i atakuar me këtë padi siç u pa gjatë shqyrtimit është i kundërligjshëm në disa drejtime , fillimisht i njëjti u nxjerr në kundërshtim të plotë me Kodin

Doganore dhe të Akcizave nenit 82 të të njëjtit, i cili parasheh kontrollin e deklaratave të veçanta doganore e jo duke shikuar mallra ad hoc te subjekteve të ndryshme ekonomike dhe duke i kërkuar te njëjtëve që te i ofrojnë dokumentacionin zhdoganues për ta kur dihet se obligim i mbajtjes së këtyre dokumenteve është afati 6 vjeçar. Vendimi është i kundërligjshëm përveç të tjerash edhe me rastin e ngarkimit të akcizës kur dihet se ky lloje obligimi ekskluzivisht ka të beje me mallrat e vena në qarkullim e që në rastin konkret paditësja me asnjë prove nuk e ka provuar se karroceritë kontestuese kanë qenë ndonjëherë si vetura në qarkullim. Pasi që të njëjta për shaka të detyrimeve nga ligji për automjete as që ka mundur të jenë në qarkullim sepse që të gjitha kanë qenë shume me të vjetra se 10 vite e kështu as taksa e doganës e as e akcizës nuk kane mundur të i vendosen te njëjtave sikurse mallra nga numri tarifor 8703. Në fund i propozojmë gjykatës që padinë e paditësi sikurse te precizuar ne këtë seance ne tërësi ta aprovojë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 15.04.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilën refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e palës së paditur deklaron se: konfirmojë se ekspertizën financiare e kemi pranuar, mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si dhe duke kundërshtuar ekspertizën financiare në tërësi pasi që e njëjta nuk është e harmonizuar me mallrat kontestuese pasi që ekspertiza financiarë i është referuar DUD - ave me numra dhe datë, ka marre të dhënat nga tabela e aktvendimit të doganës, dhe te njëjta të dhëna ia ka përshtatur DUD-ave të cekur si në ekspertize, dhe te njëjtit i kundërshtojmë pasi që nuk kanë të bëjnë me mallrat kontestuese sa i përket markave –llojeve dhe tipave si dhe numrave te karrocerisë. Sa i përket te dhënave në ekspertizë referuar taksës doganore dhe TVSH - është sikurse në bazën doganore te doganës për të njëjtën nuk kemi vërejte. Konform nenit 198 paragrafi 1 i cili ka parapare që borxhi doganor në import lind me rastin e vendosjes se mallrave në qarkullim të lirë, pra i njëjti ka disponuar me mallrat para pagesës së obligimeve doganore dhe demolomi i pjesëve te tyre nuk nënkupton dhe nuk i jep te drejte ligjore që mallrat të mos paguajnë detyrime doganore për numrin tarifor 8703 që nënkupton edhe taksën e akcizës pasi që detyrimet paguhen

në momentin e hyrjeve se tyre në Kosove, meqenëse se paditësi nuk ka prova materiale se këto mallra te jenë zhdoganuar atëherë me te drejtë është obliguar për pagese te taksës doganore, akcizës dhe TVSH-ës, po ashtu kundërshtojmë ekspertizën financiarë pasi që njëjta nuk ka vërtetuar asnjë gjendje faktike siç e kemi cekur edhe më lartë përveç që ka bërë ngatërrime të numrave te shasisë për të cilat ekspertja ne këtë seance konfirmojë se janë cekur gabimisht. Andaj i propozojë gjykatës që nga provat e administruara te refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar si të pa bazuar në ligj duke e lënë në fuqi aktvendimi e atakuar me padi. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 03.06.2024, ka administruar provat dhe atë: certifikata regjistrimit ne ARBK, aktvendimi 03.1.1-2019-331/1 i datës 14.08.2019, urdhër pagesa e detyrimeve doganore, aktvendimi 01.3.2.2/11814 i datës 30.10.2019, aktgjykimi A.nr.2947/19 i datës 08.09.2021, aktvendimi 01.3.2.2/11814 i datës 02.12.2021, DUD-at 20221, 5141, 8519, 58507, 72597, 18200, 20011, 20781, 2177, 5839, 14268, 14269, 15421, 16878, pagesa bankare e datës 07.09.2020, 05.08.2020, 06.10.2020, qarkullimi për llogari nga NLB për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, përgjigja ne padi e datës 15.04.2020, 5 fotografi te karrocive, ankesa e ushtruar ne Dogane e datës 04.09.2019, gjendja e magazinës- auto salloni date 03.09.2019, mendimi për përcaktim te vlerës date 14.06.2019, raport mbi rastin date 13.06.2019, kallëzimi penal date 20.12.2019, sqarimi për mendim tariferor i datës 22.10.2015, aktakuza e datës 26.05.2020, email – korrespondenca date 18.10.2021, 15.10.2021, 21.02.2024, raport për kontroll nga policia e Kosovës datës 14.06.2019, procesverbal mbi kontrollin e veturave, urdhër pagesa se bashku me pagesën bankare e datës 29.07.2020, ekspertiza financiarë e datës 25.04.2024, konkluzioni P.nr.12/2020 i datës 05.03.2024, pasqyra e shpenzimeve te procedurës përmbartimore ne lenden P.nr.12/2020,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se Sektori i Anti-kontrabandës i Doganës së Kosovë, me datë 13.06.2019 ka realizuar kontroll duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bashkëpunim me Njësinë e Policisë tek këtu paditësi ku është hasur në gjashtë (6) automjete të pa zhdoganuara për të cilat pala këtu paditësi nuk ka prezantuar ndonjë dokument që dëshmon zhdoganimin e atyre automjeteve. Sektori i Kontrollës pas importuese ka bërë llogaritjen e detyrimeve doganore për secilin automjet, ku shuma e përgjithshme e shmangieve doganore është 11,199.67 € prej tyre, taksa doganore 511.30 € prej tyre, taksa doganore 511.30 €, shuma e akcizës 8,200.00€ dhe shuma e TVSH-së 2,488.37 € nga kjo gjendje e konstatuar ka nxjerr Aktvendimin nr.03.1.1-2019-331/1 i datës 14.08.2019. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtuar ankesë në Doganën e Kosovës kundër këtij aktvendimi paditësi ka ushtruar ankesën e Doganën e Kosovës e për të cilin ankesë e për të cilën ankesë e paditura ka sjell aktvendimin 01.3.2.2/11814 e ndaj këtij aktvendimin paditësi ka ushtruar ankesë pran Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila me aktgjykimin A.nr.2947/19 të datës 20.09.2021 e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje. Nuk është kontestues as fakti se Dogana e Kosovës duke vepruar sipas aktgjykimi A.nr.2947/19 të datës 20.09.2021 ka sjell aktvendimin 01.3.2.2/11814 të datës 02.12.2021 me të cilën e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, e ndaj të cilit vendimi këtu paditësi me padinë e datës 14.12.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ pran kësaj gjykate.

Kontestuese në këtë kontest tregtar administrativ mbetet fakti se Dogana e Kosovës konsideron se ka të bëjë me automjetet me nr. tarifor nga kapitulli 8703 dhe jo me mall nr. tarifor nga kapitulli 8706 me pjesë të automjeteve sasi-karroceri që nuk kanë të bëjnë as për afërsisht me vetura.

Nga leximi i arsyetimit të vendimit të kontestuar del se e paditura ka theksuar se Sektori për Kontroll Pas Importuese ka vepruar drejt kur ka obliguar subjektin në procedurë që të paguaj detyrime doganore në shumën e cekur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, sepse gjatë kontrollit ishte analizuar i tërë dokumentacioni lidhur me prejardhjen doganore të mallit, ku pala nuk kishte mundur të dëshmojë se për mallin lëndor ishin kryer obligimet doganore. Tek subjekti ishin gjetur automjetet e demoluara me tabela të huaja, ku pas analizimit përmes sistemit Cognos dhe Asycuda nuk kishin gjetur dëshmi të cilat vërtetojnë pagesën e detyrimeve doganore. Deri tek këto gjetje si përfundim ishin konstatuar pasi ishte bërë verifikimi i veturave, Sektori i Kontrollit pas importues kishte bërë kërkesën për vlerësimin e automjeteve pran Sektorit të

Vlerës, ku me datë 14.06.2019 përmes shënimeve të brendshme numër protokollit 04.1.3 nr.511/14.06.2019 ishte kthyer përgjigja në lidhje me vlerësimin e automjeteve si në aktvendimet kontestuese, prandaj Sektori pas Importues pasi nuk kishte gjetur dëshmi që vërtetojnë pagesën e detyrimeve doganore për automjetet, me të drejtë kishte obliguar palën që të paguaj taksën doganore me normën prej 10% të akcizës si dhe taksën e TVSH-së me normën prej 18% pasi që këto vetura i takojnë kapitullit 8703 të Kodit Tarifor. Tutje Dogana e Kosovës ka vlerësuar se Sektori i Tarifës është sektori kompetent në Doganën e Kosovës për të bërë klasifikimin tarifor të mallrave andaj bazuar në mendimin e këtij sektori për natyrën e njëjtë që kanë të bëjnë me mallrat lëndor të njëjti klasifikohen në numrin tarifor 8703, e që i nënshtrohet pagesës së taksave të plota dhe akcizës, pasi që automjetet në fjalë në momentin kur janë blerë kanë qenë me tabela të huaja dhe borxhi doganor ka lindur në atë kohë, andaj në këtë kuptim subjekti në procedurë është dashur të kryej obligime doganore me rastin e blerjes në mallit, në vështrim të nenit 198 paragrafi 1, pika a), nenit 199, nenit 200 dhe nenit 20,2 sipas Dogana e Kosovës në rastin konkret është vepruar drejtë kur ka obliguar me pagesë të obligimeve doganore duke qenë se subjekti në procedurë ka disponuar me mallin para pagesës së obligimit doganor.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore e ka ngarkuar paditësin me obligimin doganor të pagesës së taksës së akcizës në shumë prej 8,200.00€ taksë doganore dhe me Tatim Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur përtej shumës së përcaktuar me ekspertizë financiare në emër të 6 karrocereve kontestues të gjetura tek paditësi me datë 13.06.2019, në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës e paditura nuk ka arritur të provoj me prova dhe dëshmi konkrete pretendimin se malli karroceri-automjetet e gjetur tek paditësi me datë 13.06.2019, me rastin e kontrollit të zhvilluar, është mall i cili i nënshtrohet taksës së akcizës, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 293 par.5, 6 dhe 12 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se e paditura obligimin e pagesës së paditësit me detyrime importuese doganore, respektivisht taksë doganore në shumë prej 511.30€, Akcizës në shumë prej 8,200.00€ dhe TVSH në shumë prej 2,488.37€ apo gjithsesi totali i detyrimeve në vlerë prej 11,199.67€ e ka mbështetur në mendimin për përcaktimin e vlerë nr. 03. nr.72, 73, 74 të datës 22.10.2015, e duke pretenduar se edhe malli lëndor i gjetur tek paditësi klasifikohet në numrin tarifor 8703, si mjete motorike, që i nënshtrohen pagesës së taksës doganore, akcizës dhe TVSH-së, mirëpo gjykata vlerëson se një veprim i tillë i të paditurës nuk është i bazuar në dispozita ligjore në fuqi, ngase e paditura në këtë rast ka dështuar që të paraqes ndonjë procesverbal mbi konstatimin e gjendjes faktike ku do të përshkruaj me saktësi lloji i mallit-automjeteve të gjetura tek paditësi,

gjendja e tyre, nuk ka bashkangjitur ndonjë fotografi të këtij malli, nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument për ndalimin dhe konfiskimin e mallit të gjetur tek paditësi, dhe se nuk ka arritur as të konstatoj se këto mallra si destinim kanë lëshimin në qarkullim të lirë si automjete motorike me kod tarifor 8703, përderisa vet ka konstatuar se disa prej tyre janë më të vjetra se 10 vite dhe se në nenin 44, par 2, të ligjit 05/L-132 për automjete.

Tutje, në këtë drejtim gjykata konstaton se e paditura nuk ka mundur që klasifikimin tarifor të mallit lëndor të gjetur tek paditësi, ta bazoj në mendimet për klasifikim tarifor të cilat janë nxjerr për arsye se malli kontestues nuk ka të bëjë fare me automjet, por me pjesë të automjeteve shasi-karroceri që nuk kanë të bëjnë as për afërsisht me veturë po janë pjesë të automjeteve të importuar vite më parë, fakt ky që është parë nga llager lista-gjendja e magazinave datë 03.03.2019.

Për më shumë gjykata konstaton se kur e paditura e ka ngarkuar paditësin me detyrime importuese doganore, respektivisht taksë doganore në shumë prej 511.30€, Akcizë 8,200.00€ dhe TVSH në shumë prej 2,488.37€, apo gjithsej detyrime importuese doganore në vlerë prej 11,199.64€, nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejt dispozitat ligjore të KDAK-së dhe të Ligjit nr.05/L-132 për Automjete, sepse në rastin konkret vet e paditura në vendimin e kontestuar e ka pranuar faktin se në listën e automjeteve të gjetura e që nuk i kanë paguar taksat doganore, shumica e automjeteve rezultojnë të jenë automjete që janë më të vjetra se 10 vite dhe se kjo vërtetohet edhe nga aktvendimi me nr.03.1.1-2019-331/1 i datës 14.08.2019, me të cilin paditësi është obliguar të paguaj borxhin doganor në shumë të përgjithshme prej 11,199.67 €. Në rrethanat e këtij rasti gjykata vlerëson se e paditura nuk mund të ngarkoj paditësin me pagesën e taksës së akcizës për një mall i cili ligjërisht nuk mund të importohet në Kosovë për qëllime të regjistrimit dhe lëvizjes së lirë, kjo sipas nenit 44 par.2 të Ligjit nr.05/L-132 për Automjete dhe i cili nuk mund ti nënshtrohet vendosjes në qarkullim të lirë, sepse një gjë e tillë përcaktohet edhe në dispozitën e nenit 234 të KDAK-së, ku shprehimisht thuhet se *“Akciza është taksë e cila u ngarkohet produkteve me akcizë të lëshuar në qarkullim në Kosovë”*. Gjykata vëren se në këtë linjë është edhe dispozita e nenit 237 par.1 të KDAK-së, ku parashihet që *“Secilit produkt me akcizë i caktohet akciza në tarifën e cila vlen për të në datën dhe kohën kur produkti lëshohet në qarkullim në Kosovë”*.

Gjykata konstaton se përderisa malli- automjetet e gjetura tek paditësi nuk kanë mundur as ti nënshtrohen procedurës së homologimit në fuqi në atë kohë, për të marr certifikatën e homologimit dhe procedurës së kontrollit teknik, për të marr certifikatën mbi konfirmimin e

rregullsisë teknike të automjetit, të paraparë me ligjin e përmendur dhe nenin 5 të UA nr.01/2018 për regjistrimin e mjeteve. Në nenin 13 të UA nr.2/2018 për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurave për Homologim të Mjeteve Rrugore, në fuqi në atë kohë, par.4 pika 4.4 është përcaktuar se *“Certifikata e homologimit individual për mjetin rrugor është dokumenti i cili i mundëson mjetit rrugor importimin, regjistrimin, për përdorim në trafikun rrugor”*.

Gjykata konstaton se vet e paditura Dogana e Kosovës në një rast të ngjashëm sikurse në rastin konkret me paditësin, përmes aktvendimit me nr. 05.2.1/1061, të datës 30.11.2011, për 122 automjete të gjetura tek ai subjekt të cilat kanë qenë të pa zhdoganuara, e ka obliguar të njëjtin me pagesën e vetëm taksës doganore prej 10% dhe TVSH-ë në vlerën e caktuar si mall i shitur për auto pjesë, por jo edhe me pagesën e akcizës, ndërsa në këtë rast paditësin e ka ngarkuar edhe me pagesën e taksës së akcizës në shumë prej 8,200.00€. Duke vepruar në këtë mënyrë gjykata vlerëson se e paditura nuk ka zbatuar në mënyrë unike dhe të njëtrajtshme legjislacionin doganor në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç parashihet me dispozitat e nenit 3 të KDAK-së. Shi për këtë lëndën A. nr. 927/18 të datës 19.02.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.362/22 të datës 17.04.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar F.P., e cili ka pasur për detyrë: të bëjë kalkulimin e taksë doganore dhe TVSH-së për 6 karrocëritë kontestuese dike u bazuar në bazën doganore e cila ka përcaktuar nga vetë e paditura në vendimin nr.03.1.1-2019-33/1 të datës 14.08.2019, të përcaktoj ndryshimet ndërmjet detyrimit doganor të përcaktuar me aktvendim, të konstatoj edhe faktet të tjera të rëndësishme për vendosjen e kësaj çështje juridike administrative sipas shkresave të lëndës dhe sipas vërejtjeve të palëve dhe të bëjë ekspertizën nga lëmi financiare dhe të jap konstatim dhe menim profesional.

Ekspertja financiar tek ekspertiza e datës 25.04.2024, ka dhënë konstatimet lidhur me kërkesat e dala nga aktvendimi KF.nr.362/22, ku ka theksuar pas largimit të akcizës dhe llogaritjes së Taksës Doganore dhe TVSH-së, i bie që N.T.P “Arbëri” me seli në Glllogoc i detyrohet Doganës së Kosovës 1,423.11 €.

Ekspertja financiar F.P. në seancën e datës 03.06.2024, ka deklaruar se: mbes pranë ekspertizës, bazën doganore e kame marre sikurse ne tabelën e doganës pra e njëjta nuk ndryshon, taksa doganore është 10 % në këtë baze dhe as kjo nuk ndryshon , për faktin se akcizën e kam eliminuar sipas detyrës që me është dhënë nga gjykata, atëherë del se TVSH ka ndryshime, ndryshime këto te cilat janë pasqyruara ne tabelën e fundit te ekspertizës. Sa i përket DUD ave te cekur dhe ndërlidhjes se tyre me numra te karrocerive për te njëjta deklarojë se ndërlidhjen e kame bërë gabimisht ndërsa për faktin e cekur si ne ekspertize te këtyre DUD-ave te njëjtit janë bërë vetëm për qëllime të normës se TVSH-ës, pra këta DUD a nuk kane te dhëna lidhur me karroceritë sikurse ne tabelën e aktvendimit te Doganës.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës të cekur si më lartë, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontekst tregtar administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta, për çka edhe gjykata vendosi si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, duke e anuluar pjesërisht aktvendimin me nr.01.3.2.2/11814 i datës 02.12.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe duke e detyruar të paditurën që paditësin ta liroj nga pagesa e detyrimeve importueses doganore, përkatësisht Taksa e Akcizës në shumë prej 8,200.00 € dhe nga Taksa doganore dhe TVSH-ja e llogaritur përtej shumës së përcaktuar me ekspertizë financiare, ndërsa e la në fuqi pjesën tjetër të vendimit të kontestuar me nr.01.3.2.2/11814 i datës 02.12.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në pjesën ku është konfirmuar aktvendimi me nr.01.3.22/11814 i datës 30.10.2019 i lëshuar nga ana e Sektorit të Kontrollës Pas Importuese të paditurës, me të cilin vendim paditësi është obliguar që në emër të 6 karrocerive-automjeteve të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 13.06.2019, karroceri-automjete të paguaj taksen doganore prej 10% në shumë prej 511.3€ dhe TVSH-në e llogaritur në vlerë prej 911.81€, apo gjithsej detyrime doganore në vlerë prej 1,423.11 €.

Gjykata konstaton për kodin tarifor ka vendosur vetë gjykata, ndërsa lidhur me shumën e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, u konstatua nga ekspertiza financiare e datës 25.04.2024 e ekspertes financiare F.P..

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se e paditura me të drejtë paditësin e ka ngarkuar me pagesën e taksës së doganës prej 10% në shumë prej 511.3€ dhe me TVSH-në shumë prej 911.81€, e të cilat detyrime ndryshojnë nga vlera e llogaritur nga e paditura në aktvendimin me nr.01.3.22/11814 i datës 30.10.2019, sipas ekspertizës financiare të datës 25.04.2024 dhe precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor, për mallin kontestues të pa zhdoganuar të gjetura tek paditësit me rastin e realizimit të kontrollit nga e paditura me datë 13.06.2019, në vështrim të dispozitës nga neni 200, par.1, 2 dhe 3 pika c) të KDAK-së, ku shprehimisht parashihet se ku është parashikuar se “1. *Borxhi doganor në import lind me rastin e shmangies së paligjshme nga mbikëqyrja doganore e mallrave, të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesës së detyrimeve të importit. 2. Borxhi doganor lind në çastin kur mallrat i shmangen mbikëqyrjes doganore. 3. Debitor do të jetë: çdo person që blen ose i mban mallrat në fjalë dhe në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni, se ato mallra janë larguar nga mbikëqyrja doganore*”, por nuk ka vepruar kështu edhe sa i përket taksës së akcizës dhe diferencës së taksës doganore dhe TVSH-së, për arsye se, ato karroceri-automjete përveç që nuk kanë mundur të dalin në qarkullim të lirë, nuk ka mundur të regjistrohen dhe as të përdoren për transport të personave, për çka është e ngarkueshme edhe taksa e akcizës sipas Ligjit nr.03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar ky me Ligjin me nr.03/L-220, të njëjtat as nuk kanë pasur destinim të tillë, pra nuk ka pasur kërkesë nga pala paditëse për lëshimin e tyre në qarkullimin e lirë në Kosovë respektivisht në komunikacionin rrugor në Kosovë si Automjete motorike, andaj edhe vlerësimi i tyre nga e paditura nuk është dashur të bëhet sikurse të njëjtat kishin me dalë në qarkullim të lirë si automjete motorike por se është dashur të vlerësohen sikurse karroceri – pjesë për auto vetura.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës, është marrë data 15.08.2019 e deri në kthimin e plotë.**

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal
KF.nr.362/22 datë 03.06.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.